 1. Arton Krasniqi - Zv. Udhëheqës i Personelit - Kryesues i Komisionit;
 2. Flurije Shehu –Kryeziu- Zyrtare e Lartë për Kadastër – anëtare;
 3. Ferdone Tofaj- U.D Shefe e Sektorit në Urbanizëm- anëtare;
 4. Saranda Isufaj- Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë – anëtare;
 5. Avdyli Maloku- Zv. Çertifikues Aprovues - anëtar i komisionit.
- III. Anëtarët e Komisionit Zëvendësues:
 1. Valbona Gaxherri- Gacaferi – Udhëheqëse e sektorit në Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale- Kryesuese e Komisionit;
 2. Fatmir Hoti – Lektor anëtar;
 3. Idriz Gacaferi – Inspektor i Ndërtimit –anëtar;
 4. Sundim Krasniqi - U.D Shef i Sektorit të Gjendjes Civile –anëtar;
 5. Bashkim Gaxherri- Zyrtarë për regjistrimin e pronave te paluajtshme- anëtar .
- IV. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të percaktuara sipas Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Me këtë vendim të njoftohen:

1. Zyra e personelit,
2. Anëtarët e komisionit,
3. Arkivi komunal.





REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA
PUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
Udh. Prot. 1-180/2024
No. Udh. 2703/2024
Data 27.03.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr.01/52

Datë:27.03.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008), Ligjit Nr.02/L-118 për Emrin personal, në bazë të nenit 3 pika 1 nënpika 1.12, neni 4 pika 2 e Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr.19/2015 për kushtet dhe procedurat e ndërrimit dhe korrigjimit të emrit personal, dhe në bazë të kërkesës së Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, Kryetari i Komunës me datë 27.03.2024 merr këtë:


V E N D I M

- I. Themelohet komisioni për shqyrtimin e kërkesave dhe vendosjen e tyre lidhur me ndërrimin e emrit personal, regjistrimet e më vonshme dhe korrigjimet e përbërësve të gjendjes civile që kanë të bëjnë me: regjistrin qendror dhe themeltar të të lindurve, të martuarve dhe të vdekurve në zyrën e gjendjes civile në Komunën e Junikut, me këtë përbërje:
 1. z. Sundim Krasniqi – Kryesues i Komisionit,
 2. z. Haxhë Qestaj – Zëvendës kryesues i Komisionit,
 3. z. Qendrim Knushi – Anëtar.
- II. Komisioni obligohet që lëndët të shqyrtohen në komision dhe të mbahet procesverbal për çdo lëndë të shqyrtuar, procesverbali duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës me rastin e shqyrtimit të lëndës dhe gjithmonë kërkohet kuorumi për marrjen e vendimit.
- III. Vendimet e Komisionit nënshkruhen nga Kryetari i Komisionit, në mungesë të Kryetarit të Komisionit, nënshkruhet nga ndonjëri prej anëtarëve të komisionit i cili autorizohet nga eprori përgjegjës.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme,
- Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/51

Datë: 21.03.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe neni 35 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme më datë: 21.03.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M


- I. z. **Sundim Krasniqi** i sistemuar në pozitën e punës **Zyrtar për Buxhet dhe Financa** në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, emërohet Ushtrues i detyrës Shef i sektorit të Gjendjes Civile nga data: 21.03.2024, që të punoj me kompetenca dhe përgjegjesi të plota sipas koeficientit GJ8-7.16 (Drejtuese e Ulët).
- II. I lartpërmenduri në pikën I të këtij vendimi, në këtë periudhë ngarkohet me detyrat dhe përgjegjësitë të cilat janë të përcaktuara konform legjislacionit në fuqi për fushën përkatëse.
- III. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- **Z. Sundim Krasniqi;**
- Zyrës së Personelit;
- Drejtorisë për B.F;
- Drejtorisë për A.P;
- Arkivit.



Kryetari i Komunës
z. Ruzhdi Shehu



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/50

Datë: 14.03.2024

Në mbështetje të nenit 63 paragrafi 1.1 dhe 2.1 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, dhe në bazë të nenit 5 për Transferimin e Nëpunësve Civil me datë: 14.03.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:

VENDIM

- I. Nëpunësi Civil **Avdyl Maloku** në vendin e punës: Zëvendësues i Zyrtarit Çertifikues - Aprovues, Transferohet për kohësisht në vendin e punës zyrtar për pranimin e aplikacioneve për Fermerët e Komunës së Junikut për subvencione nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillim Rural në kuadër të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik.
- II. Transferimi zgjatë 2 (dy) muaj prej ditës së nxjerrjes së këtij vendimi.
- III. Koeficienti i pagës do të jetë i njëjti me atë që ka tani .
- IV. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

ARSYETIM

Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës nga Drejtori i Zhvillimit Ekonomik, për angazhimin e zyrtarit **Avdyl Maloku**, në vendin e punës : Zëvendësues i Zyrtarit Çertifikues - Aprovues, Transferohet për kohësisht në vendin e punës zyrtar për pranimin e aplikacioneve për Fermerët e Komunës së Junikut për subvencione nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillim Rural në kuadër të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik. Ky transferim behët me qëllim të mos ngecjes së punëve dhe pranimeve të aplikacioneve për fermerët pasi që Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik nuk ka staf-zyrtar të mjaftueshëm për përballimin e këtij fluksi.


Andaj, bazuar në atë që u cek më lartë, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, u vendos si dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese prej 30 ditëve nga dita e marrjes së këtij vendimi. Ankesa i dërgohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Prishtinë.

Vendimi iu dorëzohet:

- z. Avdyl Maloku,
- Zyrës Personelit,
- Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik,
- Arkivit.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/49

Datë: 13.03.2024

Në bazë nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, nenit 81 paragrafi 7 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 7 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Kryetari i Komunës, nxjerrë këtë:

V E N D I M


- I. Themelohet komisioni përzgjedhës për përzgjedhjen e kandidatëve të cilët kanë konkurruar në pozitën e punës Asistent/e për fëmije – nxënës me nevoja të veçanta arsimore në SHFMU „Edmond Hoxha “ në Junik.
- II. Komisioni ka këtë përbërje:
 1. Zeqë Shehu – Sekretar në SHFMU “Edmond Hoxha”- Kryesues,
 2. Lumturije Lokaj-Mësimdhënëse udhëtuese në SHFMU “Edmond Hoxha”- Anëtare,
 3. Arsim Krasniqi– Përfaqësues i Sindikatës së Arsimit – Anëtarë,
 4. Saranda Isufaj – Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë – Anëtare,
 5. Arton Krasniqi- Zv. Udhëheqës i Personelit - Anëtarë,
- III. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtareve të komisionit janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ të MPMS-së - nr 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Zyra e personelit;
2. Anëtarët e komisionit;
3. Arkivi komunal.



Kryetari i Komunës
Z. Ruzhdi Shehu



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/48

Datë:13.03.2024

Në bazë të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenit 81 paragrafi 7 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, nenit 7 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Kryetari i Komunës, nxjerrë:


V E N D I M

- I. Themelohet komisioni i vlerësimit për pranim, për përzgjedhjen e personelit shëndetësor në QKMF - Junik .
- II. Komisioni ka këtë përbërje:
 1. Skender Bajraktari (Pediatër) kryesues i komisionit,
 2. Sevdije Qestaj (Zv. Kryeinfermiere) anëtare e komisionit,
 3. Zize Gjocaj (Infermiere), anëtare e komisionit,
 4. Arton Krasniqi (Zv. Udhëheqës i personelit) anëtar i komisionit,
 5. Valbona Gaxherri- Gacaferi (Udhëheqëse e sektorit për SHMS) anëtare e komisionit.
- III. Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtareve të komisionit janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ të MPMS-së - nr 07/2017, për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Anëtarët e komisionit;
- Zyra e personelit;
- Arkivi komunal.

Kryetari i Komunës
z. Ruzhdi Shehu



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/47

Datë: 12.03.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008), Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, nenit 43, si dhe Memorandumit të mirëkuptimit me numër të protokollit 1-180/2224 të datës 11.03.2024, Kryetari i Komunës me datë: 12.03.2024, merr këtë:

VENDIM PËR AUTORIZIM

- I. Autorizohet z. Milot Gashi i emëruar në vendin e punës Udhëheqës i prokurimit në Komunën e Pejës, që të ushtroj detyrën si Zyrtar për nxjerrjen e Urdhër Blerjeve në Komunën e Junikut bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit.
- II. I emëruari në pikën një (I) të këtij vendimi në bazë të certifikimit nga ana e Departamentit të thesarit për përdorim të SIMFK-së (Urdhër blerjet) do të ushtroj këto autorizime.
- III. Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdeset, Zyra e Kryetarit dhe Zyra e personelit në Komunën e Junikut.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Z. Milot Gashi
- Zyra e Personelit,
- DBF
- Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/46

Datë: 11.03.2024

Në bazë të nenit 58 paragrafi (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publikë neni 75 paragrafi 8, si dhe kërkesës me numër të protokollit 1254/2024 të datës 07.03.2024 nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Kryetari i Komunës me datë 11.03.2024 merr këtë:


V E N D I M

- I. Për përfundimin e marrëdhënies së punës të znj. Florinda Kukalaj e sistemuar në vendin e punës Zëvendësuese e Udhëheqësit të Prokurimit në Komunën e Junikut nga data: 01.03.2024.
- II. Lirimi nga detyra bëhet mbi bazën e vullnetit të znj. Florinda Kukalaj për tu liruar nga detyrat dhe përgjegjësitë e vendit të punës Zëvendësuese e Udhëheqësit të Prokurimit në Komunën e Junikut sepse me datën 01.03.2024 është punësuar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si zyrtare e prokurimit .
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Znj. Florinda Kukalaj;
- Zyra e Kryetarit;
- Zyra e Personelit;
- Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/45

Datë: 11.03.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, kërkesës nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik të datës 29.02.2024, me nr. protokollit 5-180-1893, Kryetari i Komunës me datë: 11.03.2024, merre këtë:

V E N D I M

- I. EMËROHET, komisioni për transferimin nga Komuna e Junikut në Agjencinë e Pyjore të Kosovës për stafin e sektorit të pylltarisë në këtë përbërja:
 1. Arton Krasniqi – kryesues i komisionit,
 2. Arten Hamza – anëtarë i komisionit,
 3. Avdyl Maloku - anëtarë i komisionit.

- II. Komisioni në pikën I të këtij vendimi, obligohet të bëjë transferimin nga Komuna në Agjencinë e Pyjore të Kosovës për stafin e sektorit të pylltarisë, duke u bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimit të datës 06.03.2024 me numër të protokollit 01-180-2103 në mes të Komunës së Junikut, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrisë Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik;
2. Anëtarët e Komisionit;
3. Zyra e Personelit;
4. Arkivi komunal.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/44

Datë: 07.03.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarë Publikë, Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Kryetari i Komunës me datë: 07.03.2024, merre këtë:

V E N D I M

Për pagesë retroaktive

- I. z. Ardi Qestaj i emëruar si anëtar i komisionit në shërbim civil të Komunës së Junikut në cilësinë e Ekspert i Jashtëm, në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të Burimeve Njerëzore nga organizatat e specializuara në bazë të Aktvendimit datë 12.10.2023.
- II. Pagesë retroaktive gjithsej 500.00 € , i cili ka marrë pjesë në dy konkurset publike si në vijim: Zyrtar për procedimin e të dhënave sipas numrit RN00011782 i datës. 21.08.2023 dhe Inspektor komunal sipas numrit RN00011859 21.08.2023.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim njoftohet :

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa-ZKF;
- Zyra e Personelit;
- Sistemi i Pagave – Thesar (MFPT);
- Arkivi komunal.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/43
Datë: 22.03.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, si dhe nenit 7 dhe 21 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Kryetari i Komunës me datë: 22.03.2024, merr këtë:

V E N D I M


- I. Për emërimin e komisionit të përkohshëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve në Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
- II. Komisioni do të përbëhet nga pesë (5) anëtarë dhe përbërja e tij është si në vijim:
 1. Rrustem Pepshi – Kryesues i komisionit;
 2. Valbona Gaxherri Gacaferi- anëtare;
 3. Saranda Isufaj- anëtare;
 4. Arton Krasniqi – anëtarë;
 5. Zize Gjocaj – anëtare.
- III. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me numër të protokollit 02-180-9082 të datës 06.11.2018.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Anëtarët e komisionit,
- Arkivi komunal.



Kryetari i Komunës
z. Ruzhdi Shehu



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/42

Datë: 04.03.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe neni 35 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me qëllim të mbarëvajtjes së punëve në Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis me datë: 04.03.2024, Kryetari i Komunës merr këtë:


VENDIM

- I. znj. Ferdone Tofaj e sistemuar në pozitën e punës Zyrtare e Lartë për Planifikim- Specialiste në Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, caktohet Ushtruese e detyrës Shefe e sektorit për Urbanizëm, nga data: 04.03.2024, që të punoj me kompetenca dhe përgjegjesi të plota sipas koeficientit GJ8- 7.16 (Drejtuese e Ulët) .
- II. E lartpërmendura në pikën I të këtij vendimi, në këtë periudhë ngarkohet me detyrat dhe përgjegjësitë të cilat janë të përcaktuara konform legjislacionit në fuqi për fushën përkatëse.
- III. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Znj. Ferdone Tofaj;
- Zyrës së Personelit;
- Drejtorisë për B.F;
- Drejtorisë për UKM;
- Arkivit.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/41
Datë: 04.03.2024

Në bazë të nenit 16, paragrafi. 1, pika 2.5, neni 73, përfundimi në rastet e përcaktuara nga ligji, pika 1.4 plotësohet moshja për pensionim të Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr. 08/L-197, neni 58 paragrafi (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); neni 42 paragrafi (i) dhe neni 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, Kryetari i Komunës me datë 04.03.2024 merr këtë:

V E N D I M

PËR PERFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS PËR SHKAK TË ARRITJES SE MOSHËS PËR PENSIONIM TË NËPUNËSIT CIVIL

Nëpunësi: **Haxhë Krasniqi** i sistemuar ne vendin e punës: Udhëheqës i sektorit të Gjendjes Civile në kuadër të Drejtorisë Administratë e Përgjithshme i **PERFUNDON** marrëdhënia e punës me datë: 08.03.2024, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare pensionim.

Përfundimi i marrëdhënies së punës, bëhet konform dispozitave të Ligjit, të lartë cekur pasi që i njëjti i plotëson kriteret e parapara me ligj.

Arsyetim


Duke marrë parasysh faktin që nëpunësi **Haxhë Krasniqi** i sistemuar në vendin e punës: Udhëheqës i sektorit të Gjendjes Civile në kuadër të Drejtorisë Administratë e Përgjithshme, ka arritë moshën 65 vjeçare me datë: 08.03.2024, në mbështetje të Ligjit të lartë cekur, si në hyrje të këtij Vendimi dhe të dhënave nga dosja personale, konstatojm se janë plotësuar të gjitha kushtet për ndërprerjen e marrëdhënies se punës.

Andaj u vendos si në Diapozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi u dorëzohet:

1. Nëpunësit që Pensionohet;
2. Drejtorisë për Administratën e Përgjithshme;
3. Zyres së personelit;
4. Arkivi i Komunës.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/40

Datë: 04.03.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjin e Punës Nr. 03/L212 neni 69 paragrafi 1, si dhe kërkesës me Nr. të protokollit 1-155/1931 të datës 01.03.2024, Kryetari i Komunës me datë: 04.03.2024 merr këtë:

VENDIM

- I. Për përfundimin e marrëdhënies së punës të z. Blerim Tahiraj, Mësimdhënës i Artit figurativ në shkollën e MU "Edmond Hoxha" në Junik nga data: 05.03.2024.
- II. Lirimi nga detyra bëhet mbi bazën e vullnetit të z. Blerim Tahiraj për tu liruar nga detyrat dhe përgjegjësitë e vendit të punës si Mësimdhënës i Artit figurativ në shkollën e MU "Edmond Hoxha" në Junik për arsye personale.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Z. Blerim Tahiraj;
- Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport;
- Drejtoria e shkollës fillore dhe MU' Edmond Hoxha";
- Zyra e Personelit;
- Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA
THE STATE OF KOSOVO
KOMUNA E JUNIKUT/MUNICIPALITY OF JUNIK

Idetifikuesi: 9-180/1986
Nr. i llogaritjes: 04/03/2024
Data: 04/03/2024



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/39

Datë: 04.03.2024

Në bazë të nenit 58 paragrafi (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publikë neni 75 paragrafi 8, si dhe kërkesës me numër të protokollit 6-155/1153 të datës 01.02.2024, Kryetari i Komunës me datë 04.03.2024 merr këtë:


V E N D I M

- I. Për përfundimin e marrëdhënies së punës të z. **Xhavit Jasiqi**, i sistemuar në vendin e punës Udhëheqës i sektorit në Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastër dhe Mjedis në Komunën e Junikut nga data: 04.03.2024.
- II. Lirimi nga detyra bëhet mbi bazën e vullnetit të z. **Xhavit Jasiqi** për tu liruar nga detyrat dhe përgjegjësitë e vendit të punës Udhëheqës i sektorit në Drejtorinë e Urbanizmit, Kadastër dhe Mjedis në Komunën e Junikut për arsye personale.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- z. **Xhavit Jasiqi**;
- Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis;
- Zyra e Personelit;
- Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/38
Datë: 04.03.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, kërkesës nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme të datës 01.03.2024, me nr. protokoli 1-155-1944, Kryetari i Komunës me datë: 04.03.2024, merre këtë:


V E N D I M

- I. Për themelimin e komisionit për mbikëqyrjen e shërbimeve për aktivitetin e prokurimit me titull: "Zërimi për aktivitete të ndryshme të Institucioneve Publike", me numër të prokurimit 636-24-1017-2-4-7 dhe me numër të brendshëm të prokurimit 636-24-001-247.
- II. Komisioni do të përbehet nga tre (3) anëtarë dhe përbërja e tij është si në vijim:
 1. Zeqë Shehu – kryesues i komisionit;
 2. Arton Loshaj – anëtarë i komisionit;
 3. Haxhë Qestaj - anëtarë i komisionit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Drejtoria e Administratës;
2. Zyra e Prokurimit;
3. Anëtarët e Komisionit;
4. Arkivi komunal.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/37
Datë: 01.03.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative Kryetari i Komunës me datë: 01.03.2024, merr këtë:


V E N D I M

- I. **z. Jetmir Jasiqi**, me nr. _____ emërohet Drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Junikut.
- II. Mandati i Drejtorit të Drejtorisë së përmendur me lartë do të zgjatë aq sa zgjatë mandati i Kryetarit të Komunës, apo deri në ndonjë vendim tjetër të Kryetarit të Komunës.
- III. Detyrat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara konform nenit 62.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040.
- IV. Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdeset, Zyra e Kryetarit dhe Zyra e Personelit në Komunën e Junikut.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Kryetarit.

Me Vendim njoftohen:

1. I emëruari në pikën I. të Vendimit;
2. Ministria e Administratës Publike;
3. Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/36

Datë: 01.03.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe kërkesës me Nr. të protokollit 1-155/1931 të datës 01.03.2024, Kryetari i Komunës me datë: 01.03.2024 merr këtë:

V E N D I M

- I. Për përfundimin e mandatit të punës **znj. Gentiana Tofaj**, me nr. Personal 1243976002, Drejtoreshë e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në Komunën e Junikut me datë 01.03.2024.
- II. Lirimi nga detyra bëhet mbi bazën e vullnetit të **znj. Gentiana Tofaj** për tu liruar nga detyrat dhe përgjegjësitë e vendit të punës si Drejtoreshë e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik për arsye personale.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- **Znj. Gentiana Tofaj;**
- Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik
- Zyra e Personelit;
- Arkivi.



Kryetari i Komunës
z. Ruzhdi Shehu



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/35
Datë: 29.02.2024

Në bazë në Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, nenit 13 dhe 58, nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.09.2010, kërkesës me nr. protokolli 6-351/1869 të datës: 28.02.2024, nga ‘VB. Tofaj SHPK -NIVA Construction SHPK’ , Kryetari i komunës me datë: 29.02.2024, merre këtë:

V E N D I M

- I. Për themelimin e komisionit për pranim teknik të punimeve në Projektin “Kanalizimi i ujërave të zeza, Lokacioni Moronicë dhe lagjia Krasniq me numër të prokurimit 636-23-5844-5-2-1/C172 ”.
- II. Komisioni do të përbehet nga tre (3) anëtarë dhe përbërja e tij është si në vijim:
 1. Idriz Gacaferi – kryesues i komisionit;
 2. Baki Krasniqi – anëtarë i komisionit;
 3. Arton Krasniqi - anëtarë i komisionit.
- III. Komisioni i themeluar sipas nenit II të këtij Vendimi do të hartoj Raport me shkrim për vlerësimin e punimeve konform kriterëve të përcaktuara në projektin “Kanalizimi i ujërave të zeza, Lokacioni Moronicë dhe lagjia Krasniq me numër të prokurimit 636-23-5844-5-2-1/C172 ”.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Zyra e Prokurimit;
2. Anëtarët e Komisionit;
3. Arkivi komunal.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit të Komunës së Junikut

Vendimi nr. 01/34

26 shkurt 2024, Junik

Bazuar në nenin 13, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 43 të Statutit të Komunës së Junikut nr. 001/3/27 të datës 30.09.2010, dhe në bazë të faturës numër 4-155/985, të datës 26.01.2024, Kryetari i Komunës së Junikut merr këtë:


V E N D I M

- I. Për ndarjen e mjeteve në vlerë prej 34.22€, Autoritetit përbarues “Zani” Shpk, në çështjen shërbimet e përbaruesit me rastin e përmbylljes së çështjes përbarimore për debitorin me numër **P.nr.51/23**.
- II. Shuma e përmendur në pikën I të këtij vendimi do të realizohet nga kategoria mallra dhe shërbime, dhe mjetet do të bartën në xhirrollogarinë nr. _____ në Procredit Bank.
- III. Vendimi hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
2. Pala,
3. Arkivi komunal.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/33

Datë: 23.02.2024

Në mbështetje të nenit 39 të Ligjit nr.08/L -197 për Zyrtarët Publikë, të Replikës së Kosovës dhe në bazë të nenit 4 paragrafi 1 dhe nenit 15 i Rregullorës (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe kërkesën me numër të protokollit 1-155-1761 të datës 23.02.2024 nga Drejtoria për Buxhet dhe Financë Kryetari i Komunës më datë: 23.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

- I. AUTORIZOHET Zyra e Personelit në Komunën e Junikut, për zhvillimin e Procedurës për pranim në shërbimin civil, për pozitën e planifikuar Zyrtar/e i të hyrave financiare.
- II. Zyra e Personelit është e obliguar që ti zbatoj të gjitha dispozitat ligjore të cekura me lartë në lidhje me autorizimin e cekur.
- III. Ky vendim hynë në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Zyra e Personelit,
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
3. Arkivi Komunal.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/32
Datë: 23.02.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, kërkesës nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa të datës 23.02.2024, me nr. protokoli 1-155-1774, Kryetari i Komunës me datë: 23.02.2024, merre këtë:


V E N D I M

- I. Për themelimin e komisionit për mbikëqyrjen e furnizimeve për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi me korniza për mirënjohje", me numër të prokurimit 636-24-1319-1-4-7 dhe me numër të brendshëm të prokurimit 636-24-004-147.
- II. Komisioni do të përbehet nga tre (3) anëtarë dhe përbërja e tij është si në vijim:
 1. Rruztem Pepshi - kryesues i komisionit,
 2. Valbona Gaxherri Gacaferi - anëtare e komisionit,
 3. Iliriana Isufaj - anëtare e komisionit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
2. Zyra e Prokurimit,
3. Anëtarët e Komisionit,
4. Arkivi komunal.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/31

Datë: 23.02.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); Ligji nr. 03/l-212 i punës, Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, nenit 43 dhe , Udhëzim Administrativ (mapl) nr. 01/2018 për caktimin e stafit mbështetës në komuna, neni 4, paragrafi 2 nënparagrafi 2.3, neni 8 paragrafi 6, Kryetari i Komunës me datë: 23.02.2024, bije këtë:

VENDIM

- I. **Z.Ali Gacaferi** me Nr. personal. emërohet Zyrtar Administrativ për konsultime dhe këshillime me fermer në Komunën e Junikut nga data 22.02.2024.
- II. I emëruari në pikën një (I) të këtij Vendimi do të ketë pagë mujore sipas koeficientit 5/525.00 / 1, (klasa C18- sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik) në ngarkesë të linjës buxhetore të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe kohëzgjatja e emërimit do të zgjatë sipas mandatit të Kryetarit të Komunës, apo në ndonjë Vendim tjetër.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:


- I emëruari,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Zyra e Personelit,
- Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/30
Datë: 23.02.2024



Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, neni 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës me datë 23.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

I. Për formimin e grupit punues për raportim të performancës komunale me përbërje si në vijim:


- Rustem Pepshi – Koordinator i Sistemit të menaxhimit të Performancës komunale,
- Esat Hoxha- Fusha 1: SHËRBIMET PUBLIKE DHE ADMINISTRATIVE,
- Esat Hoxha- Fusha 2: TRANSPARENCA KOMUNALE,
- Baki Krasniqi- Fusha 3: PËRGJEGJSHMËRIA KOMUNALE,
- Valbona Gaxherri-Gacaferi- Fusha 4: BARAZIA NË PUNËSIM, SHËRBIMET SOCIALE DHE FAMILJARE,
- Arton Krasniqi- Fusha 5: KULUTURË RINI DHE SPORT,
- Shkelzen Shehu- Fusha 6: MENAXHIMI I FATKEQËSIVE,
- Arian Xhuli- Fusha 7: PLANIFIKIMI HAPSINOR,
- Turim Ganijaj- Fusha 8: HAPËSIRAT PUBLIKE,
- Arian Xhuli- Fusha 9: INFRASTRUKTURA RRUGORE,
- Florant Pepshi- Fusha 10: TRANSPORTI PUBLIK,
- Turim Ganijaj -Fusha 11: SHERBIMET PUBLIKE
- Baki Krasniqi- Fusha 12: MBROJTJA E MJEDISIT,
- Ariola Krasniqi- Fusha 13: PËRFAQËSIMI GJINOR,
- Arton Krasniqi- Fusha 14: ARSIMI PARAUNIVERSITAR ,
- Valbona Gaxherri- Gacaferi- Fusha 15: KUJDESI PRIMAR SHËNDETËSOR,
- Gëzim Geci- Fusha 16: ZHVILLIMI EKONOMIK LOKAL.

II. Ky vendim hynë në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- Zyra e personelit,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- I emëruari,
- Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/29
Datë: 20.02.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, kërkesës nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme të datës 16.02.2024, me nr. protokoli 1-155-1619, Kryetari i Komunës me datë: 20.02.2024, merre këtë:

V E N D I M

- I. Për themelimin e komisionit për mbikëqyrjen e furnizimeve për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe montimi i pompës për ngrohjen qendrore", me numër të prokurimit 636-24-1047-147 dhe me numër të brendshëm të prokurimit 636-24-003-147.
- II. Komisioni do të përbehet nga tre (3) anëtarë dhe përbërja e tij është si në vijim:
 1. Avdyl Gacaferi – kryesues i komisionit,
 2. Haxhë Qestaj – anëtarë i komisionit,
 3. Gëzim Geci - anëtarë i komisionit.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Me këtë vendim të njoftohet:

1. Drejtoria e Administratës,
2. Zyra e Prokurimit,
3. Anëtarët e Komisionit,
4. Arkivi komunal.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E JUNIKUT/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/19. Print 1-184/1655
Nr. ifaq
Data 20/02/2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/28

Datë: 20.02.2024

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës të Kosovës dhe në bazë të Vendimit nr.22/178 të datës 13.12.2023 për themelimin e Mekanizmit për paralajmërimin e hershëm për monitorimin e Trendit të Migrimit (MPHMT) si dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës: 29.09.2010, Kryetari i Komunës me datë 16.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

I. Me këtë Vendim Kryetari i Komunës emëron znj. Leonita Jasiqi person kontaktues për monitorimin dhe paralajmërimin e hershëm të trendit të lëvizjes së qytetarëve në mërgim pas liberalizimit të vizave.

II. Qëllimi i funksionimit të MPHMTM është që ti mbështesë institucionet përgjegjëse për menaxhim të migrimit, pas liberalizimit të vizave në zonën Shchengen.

III. Me qellim që te kenë më shumë të dhëna nga Komuna për monitorimin e lëvizjes për migrim, e emëruara në pikën I të këtij vendimi nga Kryetari i Komunës do të jetë pikë Kontaktuese për mbledhjen e të dhënave lidhur me lëvizjen e qytetarëve të Komunës së Junikut në shtetet e zonave shchengen, pas liberalizimit të vizave.

IV. Pas mbledhjes se të dhënave ju si zyrtar përgjegjës do të raportoni tek z. Ejup Kamberaj – Udhëheqës i Divizionit për Avancimin e të drejtave të Njeriut i caktuar nga MPHMTM, ne E-mail: Ejup.kamberaj@rks-gov.net

V. Ky Vendim hynë në fuqi pas nënshkrimit të Kryetarit të Komunës

Me këtë vendim të njoftohet:

1. MPHMTM,
2. znj. Leonita Jasiqi,
3. Arkivi i Komunës së Junikut.





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK

02/Nr. Prot. 1-180/1610
Nr. llog. 1
Data 16.02.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit

Nr. 01/27

Datë: 16.02.2024

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, nenin 65 paragrafi 1,2,3,4 dhe nenin 86 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L- 197 për Zyrtarët Publikë Kryetari i Komunës me datë 16.02.2024 merr këtë:

VENDIM

- I. **Z. Musa Krasniqi** i emëruar me pozitë Nëpunës teknik dhe Mbështetës (Roje i Objektivit) në Drejtorinë e Administratës, **transferohet i përhershëm me pozitë Nëpunës teknik dhe Mbështetës në SHFMU "Edmond Hoxha" në Junik nga data 19.02.2024.**
- II. I lartpërmenduri në pikën I të këtij vendimi, ngarkohet me detyrat dhe përgjegjësitë e të njëjtës kategori sipas koeficientit 3.76 (Klasa GJ51 të Ligjit numër 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik).
- III. Zyra e Personelit brenda afateve ligjore duhet të bëjë përditësimet e nevojshme për kontratën e nëpunësit të shërbimit publik.
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen:

- I emëruari,
- Drejtoria e Administratës,
- Drejtoria për AKRS,
- Zyra e personelit,
- Arkivi.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Zyra e Kryetarit
Nr. 01/26
Datë: 16.02.2024

Në bazë të nenit 16, paragrafi. 1, pika 2.5, neni 73, përfundimi në rastet e përcaktuara nga ligji, pika 1.4 plotësohet moshja për pensionim të Ligjit për Zyrtarët Publikë, Nr. 08/L-197, neni 58 paragrafi (g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK 28/2008); neni 42 paragrafi (i) dhe neni 43 të Statutit të Komunës së Junikut të datës 29.9.2010, Kryetari i Komunës me datë 14.02.2024 merr këtë:

V E N D I M

PËR PERFUNDIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS PËR SHKAK TË ARRITJES SE MOSHËS PËR PENSIONIM TË NËPUNËSIT CIVIL

Nëpunësi: **Sali Pepshi** i sistemuar ne vendin e punës: Zyrtar për Logjistikë në kuadër të Drejtorisë Administratë e Përgjithshme i **PERFUNDON** marrëdhënia e punës me datë: 26.02.2024, për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare pensionim.

Përfundimi i marrëdhënies së punës, bëhet konform dispozitave të Ligjit, të lartë cekur pasi që i njëjti i plotëson kriteret e parapara me ligj.

Arsyetim


